**VENDIM**
**Nr.1095, datë 2.7.2008**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.194, DATË 22.4.1999 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGËS SË PUNONJËSVE MËSIMORË, NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.194, datë 22.4.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Lidhja nr.1 "Struktura e pagës për punonjësit mësimorë", e përmendur në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Lidhja nr.2 "Paga e grupit", e përmendur në pikën 2, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

c) Në paragrafin e dytë të pikës 2, fjala "në profil" shfuqizohet.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet buxhetore të planifikuara për rritjen e pagave, për vitin 2008.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2008.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

LIDHJA NR.1

STRUKTURA E PAGËS PËR PUNONJËSIT MËSIMORË TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

| | **EMËRTIMI** | **PAGA MUJORE** | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | **PAGA INDIVIDUALE** | | | **SHTESA E POZICIONIT** |
| | | **Paga e grupit (PG)** | **Shtesa për vjetërsi (SHV)** | **Shtesa për kualifikimin (SHK)** | |
| | | 1 | 2 | 3 | 4 |
| 1 | Drejtor i shkollës së mesme, Përgjegjës poligoni,<br>Drejtor i institutit të nxënësve që nuk shikojnë,<br>Drejtor i institutit të nxënësve që nuk dëgjojnë,<br>Drejtor në shkollat me probleme të larta mendore,<br>Drejtor i konvikteve | 1 | 2% e P.G. | 5% e P.G.<br>10% e P.G.<br>20% e P.G. | 40 000 |
| 2 | Zëvendësdrejtor i shkollës së mesme,<br>Përgjegjës i bazës prodhuese,<br>Zëvendësdrejtor i institutit të | 1 | 2% e P.G. | 5% e P.G.<br>10% e P.G.<br>20% e P.G. | 35 000 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | nxënësve që nuk shikojnë,<br>Zëvendësdrejtor i institutit të<br>nxënësve që nuk dëgjojnë,<br>Zëvendësdrejtor në shkollat me<br>probleme të larta mendore,<br>Drejtor i Qendrës Kulturore<br>të Fëmijëve. | | | | |
| 3 | Drejtor i shkollës 9-vjeçare | 1 | 2% e P.G. | 5% e P.G.<br>10% e P.G.<br>20% e P.G. | 31 500 |
| 4 | Drejtor i shkollës fillore klasa I-IV-ërt,<br>Përgjegjës (kryemësues) i shkollës<br>me klasë kolektive,<br>Zëvendësdrejtor i shkollës 9-vjeçare,<br>Përgjegjës sektori në Qendrën<br>Kulturore të Fëmijëve | 1 | 2% e P.G. | 5% e P.G.<br>10% e P.G.<br>20% e P.G. | 29 500 |
| 5 | Drejtor i kopshtit me ushqim | 1 | 2% e P.G. | 5% e P.G.<br>10% e P.G.<br>20% e P.G. | 28 500 |
| 6 | Drejtor i kopshtit pa ushqim | 1 | 2% e P.G. | 5% e P.G.<br>10% e P.G.<br>20% e P.G. | 26 500 |
| 7 | Mësues në shkollat e mesme,<br>Mësues në institutin e nxënësve që nuk<br>shikojnë,<br>Mësues në institutin e nxënësve<br>që nuk dëgjojnë,<br>Mësues në shkollat me<br>probleme të larta mendore,<br>Inspektor në Qendrën<br>Kulturore të Fëmijëve | 1 | 2% e P.G. | 5% e P.G.<br>10% e P.G.<br>20% e P.G. | 28 500 |
| 8 | Mësues në shkollat 9-vjeçare,<br>klasa I-IX.<br>Edukator konvikti,<br>Kujdestar konvikti | 1 | 2% e P.G. | 5% e P.G.<br>10% e P.G.<br>20% e P.G. | 25 600 |
| 9 | Edukator në kopësht fëmijësh | 1 | 2% e P.G. | 5% e P.G.<br>10% e P.G.<br>20% e P.G. | 23 000 |
| 10 | Mësues | 2 | 2% e P.G. | 5% e P.G.<br>10% e P.G.<br>20% e P.G. | 21 000 |
| 11 | Mësues | 3 | 2% e P.G. | 5% e P.G.<br>10% e P.G.<br>20% e P.G. | 21 000 |
| 12 | Edukator në kopësht fëmijësh | 3 | 2% e P.G. | 5% e P.G.<br>10% e P.G.<br>20% e P.G. | 19 300 |
| 13 | Edukator në kopësht fëmijësh | 2 | 2% e P.G. | 5% e P.G.<br>10% e P.G.<br>20% e P.G. | 19300 |

LIDHJA NR.2

VLERA E PAGËS SË GRUPIT SIPAS NIVELIT ARSIMOR

| GRUPI | PAGA NË LEKË |
|---|---|
| 1 | 11 000 |
| 2 | 9 000 |
| 3 | 7 500 |
| 4 | 4 700 |